



Home > Aktualitet > “Alo policia, këtu fshihet drogë dhe armë”/ Si u kap 17-vjeçari nga Laçi, kanabis ...

AKTUALITET

“Alo policia, këtu fshihet drogë dhe armë”/ Si u kap 17-vjeçari nga Laçi, kanabis dhe pushkë me fishekë në shtëpi, i ati nuk dinte gjë

I riu me iniciale A.M., vetëm 17 vjeç, i fshihte ato në një banesën e tij pa dijeninë e të atit.



Foto ilustruese

14 Janar, 2021 17:16

LAÇ– Një 17-vjeçar ka rënë në prangat e Policisë së Shtetit pasi është “spiunuar” se mbante në banesë armë dhe kanabis. Sipas njoftimit zyrtar të Policisë, i riu me iniciale A.M., i fshihte ato në një banesën e tij pa dijeninë e të atit. Gjatë operacionit “Skuraj 2”, u gjetën dhe sekuestruan një sasi lënde narkotike të dyshuar cannabis sativa, e ndarë në doza gati për shitje, një armë zjarri pushkë dhe 50 fishekë.

NJOFTIMI I PLOTË:

Vijojnë goditjet e njëpasnjëshme ndaj veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Skuraj 2”. Operacioni i zhvilluar nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Forcën Operacionale në DVP Lezhë dhe Komisariatin e Policisë Kurbin.

Sekuestrohen një sasi lëndë narkotike e dyshuar cannabis, një armë zjarri dhe municion luftarak.

Vihet në pranga poseduesi i tyre.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Në zbatim të planit të masave për shtimin e kontroleve në të gjithë qarkun Lezhë, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se në fshatin Skuraj, Kurbin, një person posedonte në banesë lëndë narkotike dhe armë zjarri pa leje, u organizua dhe finalizua operacioni policor i koduar “Skuraj 2”.

Si rezultat u bë kapja dhe arrestimi i shtetasit A. M., 17 vjeç, banues në Skuraj.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën ku jetonte ky shtetas, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi lëndë narkotike të dyshuar cannabis sativa, e ndarë në doza gati për shitje, një armë zjarri pushkë dhe 50 fishekë.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se 17-vjeçari ka çuar në banesë lëndën narkotike, municionin luftarak dhe armën e zjarrit, pa dijeninë e të atit të tij.

Materialet iu referuan për veprime të mëtejshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Armëmbajtja pa leje”.

(k.m/dosja.al)

ETIKETA: #Laç #operacioni Skuraj 2 #policia e shtetit

7 SHARES

Previous article
Negociatat në selinë blu/ Basha mbyll marrëveshjet me tre aleatë. Idrizi: Të ruajmë peshën specifike në zgjedhje

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet 	Aktualitet 	Aktualitet 	Aktualitet
I shpallur në kërkim ndërkombëtar, arrestohet një person në Pogradec për veprën penale...	Vit i ri, rregulla të reja/ Ndalohen sharjet në Polici! Nën at me fëmijë s'do shërbejnë më...	Arrestohen 2 persona në Pogradec, për transport të paligjshëm emigrantësh	Të shpallur në kërkim, arrestohen 5 persona në Tiranë, dhunë në familje, vjedhje dhe...

derby 300x250



STAY CONNECTED

f Facebook LIKE

t Twitter FOLLOW

i Instagram FOLLOW

y Youtube SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



14 Janar, 2021 17:16

“Alo policia, këtu fshihet drogë dhe armë”/ Si u kap 17-vjeçari nga Laçi, kanabis dhe pushkë me fishekë në shtëpi, i ati nuk dinte gjë



14 Janar, 2021 17:15

Negociatat në selinë blu/ Basha mbyll marrëveshjet me tre aleatë. Idrizi: Të ruajmë peshën specifike në zgjedhje



14 Janar, 2021 17:15

SHBA i dhuron pajisje të reja Forcave të Armatosura për të përballuar përmbytjet, Kim: Amerikanët dhe shqiptarët krah të njëri-tjetrit në kohë të vështira



14 Janar, 2021 17:10

FOTO/ Operacion në Athinë, arrestohet shqiptari me tre grekët, brenda banesës i gjendet drogë, para e pistoletë



Dosja.al është një iniciativë gazetaresh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

info@dosja.al +355 682676444

f t i o

Stafi

Drejtor : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :

Kejsi Muça
Riviera Gjyli
Anila Kolgjini
Klea Alushi
Kleida Muka

Florida Mingla
Dezdemona Kolaveri
Alberta Boseta
Izmir Akulli